



“Kujtesa Net” Sh.p.k.
Nr. i biznesit 70249238
Drejtor – Fiton PEJA
Operator i Shpërndarjes “KUGO TV”
Platforma: OTT
Prishtinë

Ref: 18011/1249/LIC/ni

VE N D I M

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, “Kugo TV”, sipas platformës OTT, me seli në
Komunën e Prishtinës

FAKTET

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati “Kugo TV” ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë të shpërndarjes sipas platformës OTT, më datën 7 nëntor 2018.

ARSYETIM

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.

6. Komisioni konstaton se, Zyra Ekzekutive, i ka otruar kandidatit per licence per operator te shperndarjes "Kugo TV" të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (Rregullorja KPM-2017/06) dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
7. Komisioni vlerëson se kandidati "Kugo TV" ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2016/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim.
8. Me Rregulloren KPM-2016/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Komisioni vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, ndërsa, kandidati "Kugo TV" ka dorëzuar një listë prej 39 kanaleve, si pjesë e katalogut programor.
9. Kandidati "Kugo TV" për operator të shpërndarjes sipas platformës OTT, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit.
10. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator të shpërndarjes "Kugo TV" mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën OTT, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati "Kugo TV" obligohet t'i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t'i ketë siguruar ato.
11. Komisioni vlerëson se, kandidati "Kugo TV" ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2016/01 si dhe me Rregulloren KPM-2017/06, për t'u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
12. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor "Kugo TV" ka përmbushur kriteret për kualifikim për t'u pajisur me licencë të KPM-së.

VENDIM

13. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur me datën 6 dhjetor 2018, merr vendim që, kandidatit "Kugo TV" i cili planifikon të operojë në Komunën e Prishtinës, t'i lëshojë licencën e KPM-së për operator të shpërndarjes sipas platformës OTT, për të ofruar shërbime të programeve në pajtim me katalogun e ofruar programor sipas marrëveshjeve për të drejtat autoriale të atyre shërbimeve mediale audiovizuale.

Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



datë